



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:008563

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03380321

P.nr.10/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit N.D nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.32/22, të datës 17.01.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.08.2022, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu dhe të pandehurit, më datë 31.08.2022 mori dhe shpalli, ndërsa më datën 01.09.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri N.D nga fsh. ... Komuna Kacanik , i lindur më dt. ... nga i ati I... dhe e ëma Sh... , e gjinisë B... , shqiptar, shtetas i Republikës e Kosoves , i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në Gjermani , i gjendjes së mesme ekonomike , me nr .personal:

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 25 Dhjetor 2021 rreth orës 15:15 min. në rrugën “Vëllezrit Çaka “ në Kaçanik, saktësisht në qendrën tregtare “... “, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të

pasurisë për vete dhe tjetrin, merr pasurinë e të dëmtuarit, në atë mënyrë që fillimisht hynë brenda në qendrën tregtare "... “ , e pastaj shkon te sektori ku kanë qenë të vendosura fishekzjarret dhe pasi që sigurohet se nuk ka ndonjë punëtor, ka marrë një komplet të fishekzjarrëve, i ka vendosur në shportë, e më pas ka arritur të largohet nga aty, pa e paguar kompletin me fishekzjarre, vlera e të cilave ka qenë rreth 95.00 €.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,3,38,43,44,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 te KPRK-së, dhe nenit 359,360,361 dhe 365 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 250.00 €(dyqind e pesedhjetë euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh.

Konfor nenit 44 të KPRK-së, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, të pandehurit I zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 450.00 € (katërqind e pesedhjetë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe atë në dy këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€, në emër të paushallit gjyqësor, derisa për Fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, "...” për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.32/22, të datës 17.01.2022, e akuzoi te pandehurin N.D nga fsh...-Kaçanik, për veprën penale, Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë te kësaj aktakuze, gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar, më dt. 29.08.2022, me te cilin rast, prokurori i shtetit Albert Zejnullahu në fjalën e tij, me rastin e prezantimit te aktakuzës, deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës se parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I pandehuri, në fjalën e tij, pas prezantimit te aktakuzës, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza. Në fjalën e tij i njëjti ka shtuar se e ndien veten të penduar për veprimin, për çka edhe i premtonte gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, andaj edhe ka kërkuar nga Gjykata që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur, mundësisht dënim me gjobë meqë është ne proces te kompletimit të dokumentacionit per bashkim familjar dhe dënimi me burg do t'i shkaktonte pasoja në këtë proces.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 248 par. 1 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se ne veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në tërësi në seancën e shqyrtimit fillestar, i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të

përsërisë veprime të tilla, ndërsa rrethane të posaçme rënduese gjykata gjeti se, bazuar në evidencën penale të kësaj gjykate, raporti i se cilës i është bashkangjitur shkresave të lëndës, i pandehuri ka patur edhe një rast tjetër penal të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë për veprën penale, Sulmi, për të cilën i njëjti është gjykuar me Vërejtje Gjyqësore.

Andaj, për këto arsye gjykata, të pandehurin N.D, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat e tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale, dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 450 par 2 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 39 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e te dëmtuarës në kontest civil, është i bazuar në dispozitën e nenit 463 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.10/22, datë 01.09.2022

Sekretarja juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.